



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës
Carina Kosova - Kosovo Customs

RAPORTI VJETOR 2021

Lista e shkurtesave

DK	Dogana e Kosovës
AEO	Operatorët e Autorizuar Ekonomik
CEFTA	Marrëveshja e tregtisë së lirë e Evropës Qendrore
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DDR	Departamentet Rajonale Doganore
DUD	Dokumenti Unik Doganor
DPI	E drejta e Pronësisë Intelektuale
MF	Ministria e Financave
MSA	Marrëveshja e stabilizim asocimit
UE	Unioni European
BK	Buxheti i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
SSP	Spektori i Standardeve Profesionale
SEEMS	Sistemi i Menaxhimit i të dhënave për Evropën Jug-lindore
PMNE	Procedurat Doganore me ndikim ekonomik
OBD	Organizata Botërore e Doganave
PT	Plani i Trajnimeve
ST	Spektori i trajnimeve
AKK	Agjencioni kundër korrupsionit
KD	Komisioni Disiplinor
GJTH	Gjykata themelore
SPPD	Spektori për Pajtuëshmërinë e Procedurave Operative Doganore
LPP,LQP,LMP,PTI	Procedural e ndërlidhura me pakot fiskale
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit
LES	Law Enforcement Information System
QRKS	Qeveria e Republikës së Kosovës

Përgatitur nga:

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Kopjet e tjera të këtij dokumenti mund të merren nga:

Zyra e shtypit, Drejtoria e Doganës, Prishtinë - Republika e Kosovës. Tel:

038 540 796 Fax: 038 540 065 E-mail: info@dogana-ks.org

Raporti është gjithashtu në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Doganës:

www.dogana-ks.org

Prill, 2022

VITI 2021 - STATISTIKAT KRYESORE

Mbledhja e të Hyrave €'000	2020	2021	ndryshimi në %
Të hyrat totale	1.052	1.370	30,47%
Taksa doganore	101.6	123.8	21 %
Akciza	398.1	501.1	25.8%
TVSH-ja	547.6	745.03	35.65
Buxheti dhe Shpenzimet			
Buxheti vjetor	10.2	10.4	2%
Paga dhe mëditje	6.1	5.8	- 4.9%
Mallra dhe shërbime	2.1	2.09	- 0.5%
Komunali	0.15	0.64	76.5%
Shpenzime Kapitale	1.85	1.87	0.8%
Kthimi i investimit (indikator)			
Shpenzimet/ të hyrat	0.009	0.008	
Vlera e mallrave në import €'000			
Vlera e Importit (IM4)	3.271	4.64	42.14 %
Pesha neto në Import (IM4)	3.91	4.6	18%
Vlera e mallrave në eksport €'000			
Vlera e Eksportit (EX1)	439.1	712.7	62.3%
Pesha neto në Eksport (EX1)	522.2	986.5	88.9%
Statistikat e operimeve			
Numri i ankesave	841	805	- 4.2 %
Numri i kundërvajtjeve	1087	1774	63%
Kallëzimet penale	111	84	- 24%
Vlera e shmangieve sipas kallëzimeve penale	2.5 milion €	2.7 milion €	+5%
Vlera e mallrave te sekuestruara	1.35 milion €	1.36 milion €	+1.2%
Gjoha	0.4 milion	1.3 milion €	230%
Vlera e deklaruar vullnetare	97.8%	93%	- 4.8 %

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Vazhdimi i përhapjes së Pandemisë COVID 19 ka bërë që viti 2021 të përshkohet nga brishtësi dhe pasiguri të theksuara duke ndikuar në të gjitha nivelet e organizimit të shoqërisë dhe shtetit, në shumë dimensione. Përtej vështirësive globale në zinxhirin furnizues, ekonomia e Kosovës ka performuar jashtëzakonisht mirë gjatë këtij viti, gjë që ka shërbyer në lehtësimin e pasojave të pandemisë.

Dogana e Kosovës, sikurse edhe institucionet tjera publike është ballafaquar me efektet e manifestimit të pandemisë ndaj stafit dhe përtej sfidave, falë angazhimit të stafit, institucioneve qeveritare dhe bashkëpunëtorëve tjerë vendor e ndërkombëtar, Dogana e Kosovës ka operuar kënaqshëm duke arritur rezultate të larta në të gjithë treguesit kryesor të performancës.

Në fushën e të hyrave Dogana e Kosovës ka arritur të tejkaloj të hyrat e vitit paraprak prej 31%. Kjo arritje është shënuar pa pasur ndonjë ndryshim në politikat fiskale, përderisa në këtë rezultat ka ndikuar me efekt kundërveprues thellimi i lirimeve nga detyrimet për produktet në import, si pasojë e thellimit të shkallës së lirimit nga marrëveshja MSA dhe marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë, si dhe po ashtu rritja e sasisë së importit të produkteve të liruara për prodhuesit si lëndë e parë dhe makineri e prodhimit. Lirimet e këtyre kategorive, krahasuar me një vit më herët kanë shënuar rritje për 42 % në vlerë të mallrave të liruara nga taksat, ndërsa detyrime të liruara nga pagesa e taksave prej 54 % më shume se vitin paraprak.

Në fushën e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjen e shoqërisë ka pasur po ashtu rritje të theksuar të rezultateve. Në aspektin e zbulimeve të mallrave të fshehta ka pasur rritje të theksuar të numrit të zbulimeve për 63% më shumë se viti paraprak dhe ngjashëm rritje e jashtëzakonshme është shënuar në zbulimin e mallrave të falsifikuara.

Hetimet e Doganës kanë shënuar rezultate mbresëlënëse, ku gjatë vitit 2021 numri i personave të arrestuar është rritur për mbi 300% ndërsa vendimet për komunikim të borxheve të zbuluara nga auditimi i Doganës pas importit, ka shënuar rritje 152% më shumë se një vit më herët.

Këto veprime përveç ndikimit në mbrojtjen e shoqërisë nga hyrjet e mallrave të paligjshme dhe të pakontrolluara, kanë ndikuar dukshëm edhe në rritjen e të hyrave dhe zhvillimin e ekonomisë si dhe kanë përmirësuar dukshëm mundësinë për kushte të drejta të tregtisë, gjë që inkurajon shtrirjen e ekonomisë së mirëfilltë ligjore dhe përmirëson afinitetin e konkureshmërisë.

Konform synimit për krijim të lehtësirave tregtare, një progres i rëndësishëm është shënuar edhe me aprovimin e dy operatorëve tjerë ekonomik të autorizuar, ndërsa që në këtë fushë dukshëm është punuar edhe me draftimin e kodit të ri doganor, i cili përveç harmonizimit me legjislacionin e BE-së, do të krijoj kushte dhe rrethana shumë më të favorshme për lehtësirat tregtare.

Duke njohur kontekstin dinamik dhe kërkesat e punës, është shumë e rëndësishme që Dogana e Kosovës të mirëmbaj një vizion të orientuar ndaj koncepteve bashkëkohore organizative, me qëllim që të ketë efikasitet në arritjen e objektivave të parapara. Disa nisma të rëndësishme mbi këtë qëllim janë në progres dhe Menaxhmenti do të jetë i orientuar për të mirëmbajtur synimin e zhvillimit të organizatës si përkushtim i vazhdueshëm.

Sinqerisht i juaji,

Agron Llugaliu

Drejtor i Përgjithshëm

PËRMBAJTJA

1. MBLEDHJA E TË HYRAVE	8
2. LEHTËSIRAT PËR BIZNESE	11
3. ZHVILLIMI I SISTEMEVE DHE PROCEDURAVE	13
4. LEGJISLACIONI	15
5. ZBATIMIT I LIGJIT	16
6. AKCIZA	18
7. LUFTIMI I KORRUPSIONIT	19
8. BUXHETI DHE FINANCAT	20
9. OPERACIONET E VEÇANTA KUNDËR KONTRABANDIMIT	22
10. PARANDALIMI I KONTRABANDËS	24

1. MBLEDHJA E TË HYRAVE

Rezultatet e doganës në fushën e mbledhjes së të hyrave në vitin 2021 kanë qenë të jashtëzakonshme, përtej projeksioneve të vëna nga Qeveria. Indikatorët kyç që kanë ndikuar në rritjen e të hyrave janë rritja e konsumit, luftimi efikas i informalitetit, trajtimi i barabartë i bizneseve, reformimi i proceseve të punës, bashkëpunimi me agjencionet tjera etj.

1.1. Të hyrat

Përkundër politikave fiskale si ndikimi i MSA-së dhe MTL-së me Turqinë dhe lirimet nga detyrimet për lëndën e parë për prodhuesit, që kanë pasur efekt në të hyra, ku përkundër këtij ndikimi nga lirimet, përgjatë vitit 2021 kanë vazhduar aktivitetet operative dhe administrative ku janë arritur rezultate të jashtëzakonshme në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit. Të hyrat e realizuara në vitin 2021 kanë shënuar rritje të madhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, por edhe me projeksionet e vëna nga QRK.

Taksat sipas llojeve	Viti 2021 Ne mil.€,	Viti 2020 Ne mil.€,	Viti 2019 Ne mil.€,	Krahasimi 2021/2020
Vlera e mallit në import	4.649,55	3.271,09	3.472,23	42.14%
Doganë	123,85	102,37	130,31	20,98%
Akcizë	501,19	398,54	431,31	25,76%
TVSH	745,03	549,21	606,57	35,65%
Total taksa	1.370,07	1.050,12	1.168,19	30,47%

Tabela e inkasimit të taksave 2021-2019¹

Në vitin 2021 janë inkasuar **1.370,07 mil.€** dhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020, ku të hyra ishin 1.050,12 mil €, janë realizuar të hyra më shumë prej 30.47 %, apo rreth 320 mil.€.



Grafikoni i te hyrave 2021-2019

Gjatë vitit 2021 drejtorja e akcizës dhe procedurave (DAP) departamenti i akcizës, tarifës, origjinës dhe procedurave doganore është angazhuar në avancimin e sistemit të procedurave doganore. Është shtuar mbikëqyrja në fushën e importit dhe prodhimit të mallrave akcizore si: duhanit dhe produkteve të tij, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, menaxhimit të banderolave të duhanit dhe produkteve të tij, menaxhimit të banderolave të pijeve alkoolike të importuara dhe ato të prodhuara brenda vendit, mbikëqyrjen e burimeve të energjisë të liruara sipas vendimit të Qeverisë.

Vlen të theksohet se ndryshimet e sistemit të harmonizuar (HS) nga ekspertet e organizatës botërore të doganës (OBD) që ndodhin çdo 5 vjet, këtë vit kanë qenë më të shumta. Për faktin se

¹ Raporti PERFORMANCA

nga organizata botërore e ushqimit janë propozuar disa ushqime të futen në listën e ushqimeve për konsum njerëzor, si p.sh. konservat me insekte etj., pastaj lëvozhga e qershisë afrikane, produkte të reja industriale, produkteve të reja të duhanit dhe përbërësve të tij, grupime, ndarje etj. Kjo ka bërë që të bëhen propozime në nivel më të lartë qeveritar për ndryshime të taksave të akcizës.

Gjatë viti 2021 janë ndërmarrë disa iniciativa të cilat kanë ndikuar në avancimin e procedurave doganore, shtim të efikasitetit dhe efektivitetit në punë.

1.2. Importi dhe eksporti

Rritja e të hyrave kryesisht mund t'i atribuohet rritjes së sasisë së mallrave të importuara, sidomos rritjes së importit të produkteve me akcizë, respektivisht mallrave strategjike (derivateve të naftës, produktet e duhanit, veturat, etj.) si dhe ngritjes së performancës së punës së Doganës.

Importi-Në vitin 2021 vlera e mallit të importuar është 4,650 mil.€ , krahasuar me vitin 2020 kemi rritje prej rreth 42.15% (2020 vlera e mallit 3,271 mil.€)

Importi i produkteve me akcizë, respektivisht mallrave strategjike gjithashtu ka shënuar rritje. Vetëm nga këto tri produkte janë inkasuar rreth 733,7 mil.€ apo 53,86% e të hyrave të përgjithshme nga importi (krahasimi 2021/2020):


Viti	2021	2020	Krahasimi 2021/2020
Derivatet e Naftës (2710)	Taksa 404,1 mil.€	Taksa 312,9 mil.€	Taksa 29,15%
Cigare(2402)	Taksa 236,1 mil.€	Taksa 173,7 mil.€	Taksa 35,92%
Veturat (8703)	Taksa 93,5 mil.€	Taksa 64,3 mil.€	Taksa 45.41%

Tabela e importit të mallrave strategjike (naftë, cigare, vetura)

Eksporti- Vitin 2021, por edhe gjatë vitit 2020 përkundër pandemisë, një trend me rritje mjaft inkurajuese për zhvillimin e mirëqenies dhe atë ekonomik është rritja e eksportit. Eksporti i produkteve kosovare këtë vit ka shënuar rritje të madhe. Është shënuar rritje si në vlerë ashtu dhe në sasi (peshë) të mallrave të eksportuara.

Në vitin 2021 trendi në rritje i eksportit të rregullt ishte i jashtëzakonshëm. Janë eksportuar mallra në vlerë prej rreth **713 mil. €**, apo **62 %** me shumë se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Rritje të madhe të eksportit ka pasur kryesisht në prodhimet e dyshekëve, produktet e hekurit, produktet e drurit , produktet e plastikës, lëngjet etj.



Grafikoni i eksportit të rregullt 2021-2019

	2021	2020	2019	Krahasimi 2021/2020
Sasia mil.kg	986,6	522,3	484,5	88,9%
Vlera e eksportit	712,76 mil. €	439.1 mil.€	349,4 mil. €	62,3%

Tabela e eksportit të rregullt EX1 (10 00) 2021-2019

2. LEHTËSIRAT PËR BIZNESE

Dogana është e orientuar në trajtim të barabartë dhe të njëtrajtshëm të bizneseve, duke iu mundësuar edhe lehtësia tregtare bizneseve kredibile dhe të besueshme.

Është rifunksionalizuar Terminali Doganor 'Tropa' që është në pronësi publike, ku tani me bizneset paguajnë një kosto minimale për procedurat doganore të qëndrimit të muanave në terminal.

Janë licencuar dy operator të autorizuar ekonomik (OAE), nga 5 sa janë licencuar gjatë tri viteve të fundit. Një OAE mund të përkufizohet si një operator ekonomik i cili konsiderohet i besueshëm, në kontekstin e procedurave doganore të tij dhe për këtë arsye ka të drejtë të gëzojë përfitime të caktuara në thjeshtezimin e procedurave doganore në të gjithë Kosovën. Beneficionet që i gezojnë OAE janë: numër më i vogël i kontrolleve të dokumenteve dhe kontrolleve fizike, trajtim me prioritet i dërgesës në rast të përzgjedhjes për kontroll, akses më i shpejtë dhe më i lehtë tek thjeshtëzimet, mundësi për të kërkuar një vend të veçantë për kontroll, lehtësime fakultative më të mëdha në procedurën e thjeshtëzuar etj.

Rendësi të madhe iu janë kushtuar edhe lehtësirave për bizneset në import dhe thjeshtëzimeve të procedurave, ku rreth 70 mijë dërgesa, kryesisht nga Shqipëria janë trajtuar me procedurë të thjeshtësuar, duke i mundësuar tregtarëve kursim të kostos prej rreth 2.5 milion euro, si dhe reduktim të kohës së nevojshme për procedurat doganore. Gjatë vitit që lamë pas njësitet e doganës kanë qenë në përkrahje të prodhuesve, si një vlerë e rëndësishme për ekonominë kosovare dhe zhvillimin e ekonomik, duke ju mundësuar procedura me të thjeshta dhe të shpejta. Janë proceduar me qindra autorizime për prodhues, ku lirimet për lëndë të parë, burime të energjisë, pjesë rezervë, pajisje të teknologjisë së informacionit dhe makinerive prodhuese kanë arritur shumën e taksave prej 126.8 mil.€, gjersa për periudhën e njëjtë të vitit 2020 ishte 80.3 mil.€, apo 57.9% më shumë. Në këtë kategori që kanë qenë të liruar nga taksat në import për lëndën e parë dhe të gjitha inputet që përdoren në proces të prodhimit, ka pasur efekt në projeksionin, mirëpo efekti pozitiv në këtë kategori, është tek rritja ekonomike, ku në vitin që lamë pas kemi rritje eksportit 62% në vlerë.

MSA në vitin 2021- sa i përket ndikimit në taksë ka qenë rreth 97.2 mil.€, krahasuar me vitin 2020 që ishte 67.9 mil.€. Kështu është shënuar rritje prej 43%. Efekt tjetër në të hyra kishte edhe **ndikimi i MTL me Turqinë** në vlerë prej rreth 20.7 mil.€, krahasuar me vitin 2020, që ishte 10.6 mil.€. Kështu, është shënuar rritje prej 95,6%.

Tabela e lirimeve nga taksat 2021-2020

	Viti 2021 Taksat e liruara mil.€,	Viti 2020 Taksat e liruara mil.€,	Krahasimi %
--	---	--------------------------------------	-------------

Lirimet Fiskale	Pako	126.8	80.3	57.9%
MSA		97.2	67.9	43%
MTL me Turqi		20.7	10.6	95.6%
Total lirimet		244.7	158.8	54.1%

Gjithashtu pas vendimit te MINT-it përmes te cilit autorizohet Dogana për kontrollin e cilësisë se derivateve te naftës, Dogana ka ndërmarrë veprimet konform autorizimeve dhe si rrjedhojë kursimet e bizneseve janë rreth 1 milion €, e te cilat ne te kaluaren iu janë paguar trupave inspektuese - TVK për vlerësim të konformitetit dhe testimit të të ngarkesave në laborator.

3. ZHVILLIMI I SISTEMEVE DHE PROCEDURAVE

Dogana ka zhvilluar dhe përditësuar module dhe programe të cilat kanë pasur qëllimin e lehtësimin e punës, komunikimin me të lehtë me bizneset dhe qytetaret, bashkëpunim ndërinstitucional etj. .

Zhvillimi i sistemit SIMS dhe përditësimi i moduleve ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2021 dhe është arritur të përfundohen dhe përditësohen moduli i transportit dhe moduli i trajnimeve.

Zhvillimi i aplikacionit mobil eDogana
Qellimi i lansimit të këtij aplikacioni është bashkëpunimi me qytetaret me qëllim të lajmerimit të parregullsive, kontrabandes, shkeljes së detyres zyrtare, verifikimin e kilometrazhes së automjeteve, thirrjet pa pagesë etj. Ky aplikacion është krijuar nga resurset e brendshme të Doganës dhe është i qasshem dhe mund të downloadohet pa pagesë në platformat Android dhe IOS.



nCEN (The National Customs Enforcement Network) është sistem i zhvilluar nga OBD për t'iu asistuar Doganave për administrim dhe ruajtje të informatave të Zbatimit të Ligjit, në nivel nacional dhe shkëmbimin e informatave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Gjatë vitit 2021 është bërë përditësimi i sistemit nCEN në dy versione të reja të cilat Organizata Botërore e Doganave ka nxjerrë në shfrytëzim dhe ato menjëherë janë implementuar në infrastrukturën e DK

Trajnimet

Në anën tjetër dogana ka punuar edhe në avancimin dhe zhvillimin e stafit ku janë realizuar gjithsej 90 aktiviteteve trajnuese zhvillimore, në 78 fusha të ndryshme profesionale, menaxhuese dhe teknike.

Periodha raportuese përmbyllet me 489 Oficer dhe Zyrtar Doganor të trajnuar në kuadër të aktiviteteve të brendshme të DK-së dhe asistencës-aktiviteteve nga jashtë ku duhet theksuar bashkëpunimin me EXBS, përmes të cilëve gjatë këtij vitit kanë qenë 4 aktivitete trajnuese me gjithsej 49 oficer të trajnuar si dhe bashkëpunimin me AKSP dhe institucionet tjera.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Dogana e Kosovës për here të pare përfaqësohet me atashenun Doganor , i cili është i sistemuar ne ambasadën e RKS ne Bruksel.

Në fushën e Bashkëpunimit Ndërkombëtar përgjatë periudhës raportuese, janë realizuar rreth 89 aktivitete në shkëmbim të korrespondencave me administratat doganore të vendeve tjera, si përgjigje apo kërkesa për verifikime dhe informacione etj.

Jane zhvilluar takime bilaterale të nivelit të lartë, respektivisht të Drejtorëve të Përgjithshëm, me vendet e regjionit , ku duhet theksuar tre takime bilaterale, dy nga to me Doganën e Shqipërisë dhe një me Doganën e Maqedonisë së Veriut. Qellimi i takimeve ka qene lehtësimi i te berit biznes përmes bashkëpunimit te Doganave respektive. Takimet me administratën Doganore te Shqiperise kane rezultuar e nënshkrimin e 3 marrveshjeve mes drejtove te te dyja Doganave dhe një marrëveshje ne fushën e Doganave është nënshkruar ne takimin e kryeministrave te te dyja shteteve.

OBD- Organizata Botërore e Doganave: Në mesin e aktiviteteve të organizuara nga OBD, DK ka marr pjese ne 67 aktivitete te organizuara nga OBD. Është krijuar grupi për shqyrtimin e zbatimit te Konventës se rishikuar te Kyotos, ku finalizimi i matjes se përputhshmërisë pritet te realizohet gjate pjesës se pare te vitit 2022.

4. LEGJISLACIONI

Gjate këtij viti, duke zbatuar planit strategjik dhe planin e veprimit, Dogana e Kosovës, në kuadër të kompetencave ligjore ka treguar një performancë të mire të punës dhe profesionalizëm në trajtimin e ankesave të subjekteve ndaj vendimeve të DK-se, dhënien e opinionëve ligjore, draftimin e akteve e ndryshme ligjore, zbatimin e planit legjislativ të QRK-se dhe të DK-se për vitin 2021, si dhe përfaqësimin e DK-se në konteste të ndryshme administrative, civile, dhe penale.

Gjatë vitit 2021, me rishqyrtimin e vendimeve janë pranuar gjithsejtë 805 kërkesa të rregullta për rishqyrtim dhe **196** kërkesa të kthyera në rivendosje nga Gjykata Themelore, apo në total **1001** lende. Në raport me vitin 2020 kemi rënie të numrit të ankesave të rregullta

Lende/kërkesa të rregullta të përfunduara janë **788**, deri sa **198** të kthyera në rivendosje nga Gjykata, apo në total të përfunduara **986** lende

Si edhe në vitin paraprak vazhdojnë të dominojnë kërkesat për rivlerësim të mallit, të cilat përfaqësojnë mbi 70% të kërkesa të përgjithshme, deri sa po ashtu lende të refuzuara janë mbi 75% nga totali i atyre të përfunduara.

Në Sektorin e Përfaqësimeve në Gjykata gjatë vitit 2021 zyrtaret e doganës që përfaqësojnë lendet doganore, kanë marrë pjesë në **1022** seanca të ndryshme nga Gjykatat e gjitha niveleve dhe kompetencave të ndryshme, që në raport me vitin paraprak është një rritje prej **294** ftesave. Janë përgatitur **505** parashtesa të ndryshme deri sa janë parashtruar **107** ankesa në Gjykatën e Apelit dhe 5 ankesa në Gjykatën Supreme. Tek përmbaruesi janë dërguar **119** lende

Gjatë vitit 2021 janë dhënë 602 këshilla ligjore për subjektet e ndryshme, palët fizike, institucionet shtetërore dhe strukturat e DK-se. Sa i përket dinamikës së përgatitjes së infrastrukturës ligjore ky vit ka qenë jashtëzakonisht i ngarkuar, pas parasysh formimit të GP për draftimin e Kodit doganor dhe Akcizave dhe ligjeve tjera nga fushëveprimi i DK-ne zbatim të Programit legjislativ 2021 të Qeverisë së Kosovës. Në aspektin e zbatimit të programit legjislativ të QRK-se për vitin 2021, përveç angazhimit në projektligjin për Kodin Doganor dhe të Akcizave, ka pasur aktivitet të vazhduar në projektligjin për ndryshim dhe plotësim të ligjit për akcizën në produktet e duhanit, si dhe kontribut në tre projektligje tjera aktive, e të cilat sponsorizohen nga ministritë tjera.

Në krahasim me vitin e kaluar në të gjithat fushat e punës së sektorit ka pasur rritje prej rreth 30% të numrit të përfaqësimeve dhe shkresave të përgatitura për të gjitha procedurat që zhvillohen pranë Gjykatave.

5. ZBATIMIT I LIGJIT

Dogana gjatë vitit 2021, në aspektin e zbatimit të ligjit, ka vepruar duke u bazuar në konceptet moderne të selektimit dhe udhëheqjes së aktiviteteve operativës përmes inteligjencës më bashkëkohore, në luftën kundër kontrabandës, krimit të organizuar trans kufitar, dhe informalitetit në fushën e përgjegjësisë së Doganës së Kosovës.

Dogana e Kosovës me qellim së arritjes së objektivave strategjike ka marrë këto veprime:

- Njësitët Antikontrabande kanë kryer **3919 Ndalesa rrugore / 5604 Kontrolla** në vendkalime Kufitare, pjesëmarrje në **76** Plane Operative me Agjencione të tjera të Zbatimit të ligjit
- Kontrolli Post Importuese ka kryer **187** Kontrolla të rregullta si dhe pa paralajmërim dhe me këtë rast janë lëshuar **124** aktvendime për Inkasim në vlerë prej **3,361,650.63 Euro**.
- Jane trajtuar **1774 Kundërvajtje** doganore të zbuluara nga të gjitha Zyrat / Sektorët e Doganës me mall në vlerë prej **4,107,699.30 €** dhe janë shqiptuar gjopa në vlerë prej **1,366,161.77 €**.
- Jane Verifikuar mallra në **355 raste**, ku janë ndaluar për verifikim **690,356** Artikuj dhe është konfiskuar mall i falsifikuar në vlerë prej **4,988,351.00 Euro**. Janë asgjësuar **80,931 Artikuj** në vlerë prej **3,351,423.00 Euro**.
- Jane regjistruar **96 raste** të reja për Hetime, dhe i ka dorëzuar **84 Kallëzime Penale** pranë prokurorive përgjegjëse ku janë siguruar prova të mjaftueshme se kemi të bëjmë me shmangie nga Detyrimet doganore në vlerë prej **2,714,962.41 €**, dhe është sekuestruar mall në vlerë prej **1,376,181.59 Euro**. Për kontrabandim dhe shmangies nga Tatimet e Detyrueshme nga Hetuesia Doganore janë intervistuar **136 persona** të dyshuar dhe janë arrestuar **13 Persona**.
- Analiza e riskut gjatë kësaj kohe ka shënjestruar **486** dërgesa për kontrolla detaje nga SMPC apo AK dhe janë krijuar **155** Profile të reja të riskut dhe janë modifikuar **109** Profile.


Parandalimi i ekonomisë joformale

Gjatë vitit 2021 luftimi i ekonomisë jo-formale është orientuar në disa nga fushat specifike të konsideruara si fusha me risk të lartë sic është fushat e lirimeve të mallrave nga pagesa e taksës së akcizës si fushë me prioritet, por duke mos anashkaluar fushat tjera të nënvlerësimit, kontrabandës etj.

Orientimi i grupeve Punuese të DK për inspektimin e kompanive importuese të lëndës së parë për prodhim dhe kompanive përpunuese të derivateve të naftës, respektivisht të autorizuar nga Dogana e Kosovës për procedurën e përpunimit nën kontroll doganor ka parandaluar informalitetin ku sipas të dhënave të importit ka rënë sasia e importit të vajit për ngrohje krahasuar me vitin e kaluar, ndërkohë, sasia e lëndës së parë për prodhim është rritur e që duhej të ndodhte e kundërta.

Ulja e burimeve të energjisë për prodhim përkundër rritjes së lëndës së parë për prodhim në masë, vjen si rezultat i rritjes së mbikëqyrjes dhe luftimit të informalitetit tek ky sektorë.

Në parandalimin e informalitetit në të gjitha fushat kanë ndikuar luftimi i kontrabandës përmes vijës së gjelbër të kufirit nga AKQ dhe intensifikimi i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të cilësisë nga SMPC-se në importin e rregullt të këtyre mallrave.



6. LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Stafi i Doganes paguhet nga taksapaguesit e Kosovës, andaj edhe rrjedhin obligime ligjore që secili cent i buxhetit që mblidhet si dhe atë pjesë të buxhetit që shpenzohet te jenë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe normat ligjore në fuqi. Sektori i Standardeve Profesionale dhe Sektori i Hetimeve kane punuar gjatë vitit 2021 në rritjen e aktiviteteve ashtu që të sigurohen që stafi i doganës respekton standardet më të larta profesionale. Gjatë vitit 2021, ekipi i SSP(sektori i Standardeve profesionale) dhe komisionet disiplinore kane arritur që t'i realizojë objektivat ku si rezultate jane: 9 zyrtare doganore te suspenduar 1 perjashtim nga puna, 1 paraperjashtim 10 denime financiare, etj.

Gjatë këtij viti është rritur numri i informatave të pranuara, ku disa prej tyre janë përfunduar në nivel lokal si dhe një numër i tyre është hedhur poshtë në mungesë provash. Disa nga informatat janë hetuar në procedurë të rregullt disiplinore dhe rastet janë deleguar në Komision Disiplinor për shqyrtim disiplinor dhe vendim-marrje.

Paraqitja tabelore: (Vërejtje: një rast mund të përfshijë më shumë se një zyrtar):

Periudha	Viti 2020	Viti 2021
Informata te pranuar	7	11
Informata të trajtuara	10	7
Raste disiplinore te iniciuara	26	23
Suspendime	1	9
Vazhdime të suspendimeve nga vitet paraprake	5	6
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	0	1
Degradim	1	0
Paraperjashtim	0	1

Edhe gjatë këtij vitit është vazhduar me zbatimin e masave disiplinore konform fakteve të shqyrtuara përmes vendimeve si në nivel lokal, ashtu edhe në Komision Disiplinor. Vlen të theksohet se kemi një rritje të numrit të suspendimeve si rezultat i reagimit të vendosur të Doganës ndaj zyrtarëve që janë të dyshuar se kanë kryer vepra penale apo janë subjekt i hetimit penal. Hetimet në lidhje me rastet e dyshuara penale janë duke u zhvilluar konform procedurave të parapare me Kodin e Procedurës Penale në Kosovë.

7. BUXHETI DHE FINANCAT

Në bazë të Ligjit nr. 07/L-041 - mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dhe në bazë të vendimit të qeverisë nr.01/69 të dt.15.03.2021 pika 3 pagesat për shtesa për zyrtaret e DK-së të ekspozuar drejtë për drejt ndaj pandemisë COVID -19 Doganës ju janë ndare buxhet shtese në kategorinë e shpenzimeve paga dhe mëditje në shumën prej **74,000.00** euro, gjithashtu bazë të Ligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e republikës së Kosovës për vitin 2021 të datës 04.08.2021 Doganës ju janë ndare buxhet sipas kategorisë së shpenzimeve të paraqitura në tabelën vijim.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2021, kursimet buxhetore janë në lartësi prej 2.35 Milion €, e gjithë kjo pa cenuar vijueshmërinë e punëve për të cilat Dogana ka obligime dhe përgjegjësi

Buxheti i aprovuar / i rishikuar / shkurtimeve dhe buxheti përfundimtar 2021

Kodi ekonomik	Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti i aprovuar sipas ligjit Nr. 07/L-041	Buxheti i aprovuar Sipas vendimit të qeverisë nr.01/69-15.03.2021	Buxheti i aprovuar sipas ligjit Nr.08/L-016 04.08.2021	Buxheti i aprovuar nëntor 2021	Buxheti sipas shkurtimeve nga MF 15.12.2021 dhjetor 2021	Buxheti final sipas SMFK 10.01.2021
	<i>Nr. lejuar</i>	581	581	581	581	581	581
11100	Paga dhe Mëditje	6,417,127.00	6,491,127.41	6,526,127.00	6,526,127.42	6,526,127.42	5,815,101.06
13000	Mallra dhe Shërbim	2,055,086.00	2,055,086.00	2,185,086.00	2,144,086.00	2,144,086.00	2,098,749.00
13200	Shpenzime Komunale	169,375.00	169,375.00	169,375.00	169,375.00	169,375.00	64,529.71
03000	Shpenzimet Kapitale	1,700,000.00	1,700,000.00	2,200,000.00	2,200,000.00	1,872,430.02	1,872,430.02
	Totali	10,341,588.00	10,415,588.41	11,080,588.00	11,039,588.42	10,712,018.44	9,850,809.79

Sektori i prokurimit gjatë vitit 2021 ka kryer punët që janë në fushëveprimin e këtij sektori të përcaktuara me LPP dhe UA për shitje të mallrave të konfiskuara.

Gjatë këtij viti, angazhimi i sektorit ka qenë kryesisht i orientuar në përgatitjen e procedurave të tenderëve dhe kontratave. Dogana ka nënshkruar 53 kontrata nga aktivitetet e prokurimit. Gjithashtu përmes modulit të blerjes janë ekzekutuar gjithsej 365

urdhër blerje në vlerën totale prej 1,853,388.86 euro. Në përgjithësi janë mbajtur 63 aktivitete të prokurimit.

Gjithashtu janë realizuar shitjet përmes përmes sistemit të *eprokurimit* ku në bazë të raporteve, vlera e shitjeve të mallrave të konfiskuara dhe aseteve është rreth 106,872.93 euro

8. OPERACIONET E VEÇANTA KUNDËR KONTRABANDIMIT

Gjatë këtij viti Dogana ka kryer një numër të aksioneve të suksesshme dhe ka arritur rezultate të lakmueshme. Raste e zbulimeve të Doganës gjatë vitit 2021 ishin si në vijim:

- Ne PKK Vermice Dogana ka arritur të parandalojnë kontrabandimin e substancave narkotike në sasi prej 7.8 kilogram, ndërkaq në një rast tjetër është organizuar një plan Operativ dhe si rrjedhojë në dy raste të ndara janë zbuluar një Arme Zjarri dhe Një Pako me Barna duke tentuar të kontrabandohen. Po ashtu është parandaluar edhe një rast i Kontrabandimit të 6 Iphone 13.
- Në rajonin e Prizrenit Dogana ka organizuar një kontrollë në dy lokacione të dyshimta dhe me këtë rast është hasur në një sasi të konsiderueshme të mallit të kontrabanduar nga Shqipëria. Dërgesa Postare të ndryshme (164 Dërgesa/Pako) me vlerë prej 7,639,80 Euro dhe Kafe Turke (430kg) me vlerë prej 2,107.00 Euro, ndërkaq në dy raste tjera tjetër është arritur të identifikohen dhe ndalohen Automjet me Cigare të kontrabanduara ku janë sekuestruar 650.000 cope Cigare. (shmangiet nga detyrimet 42.000 Euro), respektivisht 283.9600 cope Cigare. (shmangiet nga detyrimet 20.000 Euro)
- Në PKK Hani i Elezit mes tjerash janë zbuluar 4 raste të tentim kontrabandes. Në rastin e parë në një automjet udhëtarësh në një hapësirë të fshehtë post-fabrikante janë gjetur 45 telefona celular. Në rastin e dytë në një Autobus Udhëtarësh është gjetur një sasi e konsiderueshme e Produkteve Farmaceutike / Hormone për Stimulim të Fekondimit Artificial. Në rastin e tretë është arritur të parandalohet kontrabandimi i një Arme / Pistoletë 7.65 mm dhe 7 fisheke.
- Ndërkaq në rastin e katërt, pas hetimeve, me urdhër të Prokurorisë Themelore në Ferizaj është ndaluar një i dyshimte me mallra të kontrabanduara përmes PKK Hani i Elezit, pasi që ka kaluar kufirin pa kontrollë dhe me këtë rast pasi që është argumentuar se në Veturën e tij ka mallra të padëklaruara personi i dyshuar është ndaluar dhe po ashtu edhe Zyrtari Doganor i cili ia ka mundësuar hyrjen në Kosovë pa kontrollë dhe pagesa të taksave të aplikueshme Doganore është arrestuar. Gjithashtu në këtë region në një operacion tjetër janë kryer kontrollat në 6 lokacione të dyshimta dhe me këtë rast janë konfiskuar mbi 100 kg Nargjile dhe 5674 Cigare Marlboro dhe 5734 Cigare Elektronike (Heets).

- Ne PKK Merdare njësitet e Doganes kane arritur te zbulojne dhe parandalojne kontrabandimin e tri armeve dhe nje sasi te koniderueshme te auto Pjesëve te cilat kane tentuar te hyjnë ne Kosovë pa u deklaruar përmes linjave ndërkombëtarë te Autobusëve.
- Ne Prishtine është kontrolluar një lokal i dyshimte dhe me këtë rast është hasur ne një sasi te konsiderueshme te Duhanit per Nargjile te kontrabanduar ku janë sekuestruar 506 Kg. (shmangiet nga detyrimet 23.168 Euro). Dogana e Kosovës i ka kontrolluar 8 lokacione te dyshimta dhe me këtë rast janë konfiskuar rreth 300 Telefona Smart te Kontrabanduar.
- Ne Fushe Kosove është arritur te identifikohet dhe ndalohet një Automjet me Cigare te kontrabanduara ku janë sekuestruar 750.000 cope Cigare. (shmangiet nga detyrimet 46.000 Euro)
- Ne PKK Aeroport është arritur te Parandalohet Kontrabandimi i 11.12kg Stoli Argjendi
- Ne regjionin e Gjakovës me urdhër te Gjykatës Themelore ne Gjakove dhe nen udhëheqjen e Prokurorisë janë kontrolluar 4 lokacione te dyshimta per prodhim ilegal te pijeve alkoolike dhe me këtë rast janë sekuestruar 14,828 Litra Pije Alkoolike (Raki)
- Ne Mitrovicë është arritur te identifikohet një depo me Cigare te kontrabanduara ku është sekuestruar 2000 kg Cigare
- Pas pranimit të informatave përmes rrugëve operative, njësitet e Doganes kane kryer një kontrolla shume lokacionet ku jane gjetur 1490 kg nargjile te kontrabanduara, 3 automjetet transportuese me 3500 kg fishekzjarrë te kontrabanduara, nje kamion me 5000 kg duhan te kontrabanduar, 52000.00 CHF te padeklaruara, 1296 litra pije alkoolike etj.
- Ne nje operacion te përbashkët me Policine e Kosoves ne disa lokacione te Kosoves janë kryer Kontrolla/Bastisje nen udhëheqjen e Prokurorisë dhe me Urdhëresë te Gjykatës dhe me këtë rast janë arrestuar 8 persona te dyshimte (5 janë ne Kërkim) dhe është sekuestruar një sasi e konsiderueshme e mallit te kontrabanduar si Pije Alkoolike de joalkoolike, Mallra ushqimore, Cigare, produkte higjienike etj

- Ne një Operacion te përbashkët te DK dhe ATK janë kontrolluar tri subjekte dhe me këtë rast është sekuestruar malle i kontrabanduar (3079 Artikuj) ne vlere prej 14,752.00 Euro dhe tri automjete te pazhdoganura ne vlere prej 25,462.00 Euro.


9. PARANDALIMI I KONTRABANDËS



1 mars 2021, njësit e Doganës dhe pasdite në pike kalimin kufitar të Vërmicës kanë arritur të parandalojnë futjen e substancave narkotike në sasi prej 7.8 kilogram.



17 mars 2021 në një automjet udhëtaresh në një hapësirë të fshehtë post-fabrikante janë gjetur 45 telefona celular

	31 mars 2021 njësite e Doganës kanë parandaluar kontrabandimin e produkteve ushqimore.
	14 prill 2021 Një automjete që vinte nga Maqedonia është sekektuar për kontroll dhe gjatë kontrollit të hollësishëm në anën e djathtë në sirtar janë hasur ne tre qese, pas hapjes se te njëjtave janë gjetur mjete monetare të padeklaruara në vlere totale prej 28,310.00 euro.



Prishtinë 1 maj 2021 Njësitët e anti-kontrabandës kanë identifikuar një automjet të dyshuar të cilin e kanë ndaluar dhe pas kontrollimit janë gjetur të ngarkuara 10 paketa me cigare të kontrabanduara respektivisht 100,000 copë cigare.



8 maj 2021 njësite e Doganës kanë kontrolluar dhe gjetur sasi të konsiderueshme të nargjilesë në një lokacion në Malishevë

	19 maj 2021 zbulohet depo e improvizuar private në një parking nëntokësore në Prishtinë. Duke vepruar mbi këto indikacione dhe në bashkëpunim dhe udhëheqje të Prokurorisë Themelore të Ferizajt, zyrtaret doganor kanë hyrë në këtë depo, ku kane gjetur stok të konsiderueshme të barërave ilegale në sasi prej 17, 923 pako, 359 lloje te barnave
	2 qershor 2021 Njësit e Doganës sot në Mitrovicën veriore kanë kryer një kontrolle në një depo të dyshuar për mallra të kontrabanduara. Gjatë kontrollit janë gjetur sasi të konsiderueshme te cilat dyshohet se janë futur të kontrabanduara. Njësitet antikontrbandë kanë bërë konfiskimin e duhant dhe cigareve derisa sipas urdhrorit të Prokurorisë themelore në Mitrovicë dhe nën udhëheqjen e tyre është duke u intervistuar pronari. Sasia e konfiskuar sot është 2100 kg cigare dhe duhan i grirë (200kg).
	nen udhëheqjen e Prokurorisë janë kontrolluar 4 lokacione te dyshimta per prodhim ilegal te pijeve alkoolike dhe me ketë rast janë sekuestruar 14,828 Litra Pije Alkoolike (Raki)

	11 qershor 2021, Njësitet e Antikontrabandës së Doganës së Kosovës kanë arritur ta identifikojnë dhe ndalojnë një veturë të dyshimte dhe me këtë rast janë gjetur 61 telefona Mobil pa dokumentacion/të kontrabanduar
	13 qershor 2021 njësitet e antikontrabandës të Doganës së Kosovës kanë kryer një operacion të suksesshëm në regjionin e Mitrovicës me qëllim të identifikimit dhe ndalimit të Kontrabandës së mallrave përmes rrugëve ilegale.
	16 qershor 2021 Në Aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" oficerët dogana kanë ndaluar për kontroll një udhëtar, i cili ka kaluar në kanalin e gjelbër dhe është selektuar për kontroll. Pas imazheve të skanimit të cilat kanë detektuar mallra të ndaluara është kërkuar edhe kontrolli fizik i valixhes dhe gjatë kontrollit fizik të valixhes është hasur në mallra të ndaluar


	26 qershor 2021 Njësitët Antikontrabandë të Doganës së Kosovës me qëllim të luftimit të kontrabandës së mallrave përmes rrugëve ilegale kanë kryer një Operacion të suksesshëm në regjionin e Mitrovicës, pas pranimit të informatave përmes rrugëve operative. Me këtë rast është arritur të identifikohet dhe ndalohet një kamion i cili ishte duke transportuar mallra të kontrabanduara (Duhan i Papërpunuar) në sasi prej 5,000 Kg.
	24 gusht 2021 Në pikë-kalimin kufitar të Dheu të Bardh oficerët doganor kanë arritur të parandalojnë futjen e mallrave të kontrabanduara. Vetura është selektuar për kontroll detal ku dogana është asistuar edhe nga policia dhe gjatë kontrollit janë gjetur të padeklaruara një sasi e testeve të shpejta për COVID-19.
	8 shtator 2021.- njësit e doganës parandalojnë tentim kontrabandën e rreth 9 kilogram substanca narkotike që dyshohen të jenë të llojit kokainë.

	11 shtator 2021 - në afërsi të Zveçanit, njësitë antikontrabandë të Doganës së Kosovës kanë ndaluar për kontrollë një kamion të tonazhit të ultë, pas dyshimeve se mund të ketë mallra kontrabandë. Fillimisht drejtuesi i kamionit ka tentuar të largohet por intervenimi i suksesshëm oficerëve ka rezultuar me ndalimin e këtij mjeti transportues.
	15 shtator 2021 - njësit e doganës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë ushtruar kontroll të befasishëm në një depo të mallrave në Mitrovicën e veriut. Gjatë kontrollit janë gjetur sasi të konsiderueshme të mallrave të cilat nuk kishin asnjë mbulesë dokumentare të gjitha mallrat me origjinë nga Serbia.

	8 tetor 2021 – ne pikë kalimin kufitar të Dheut të Bardh njësit e antikontrabandës së Doganës së Kosovës kanë selektuar një veture e dyshimtë për kontrollë detal. Pas kontrollimit të udhëtarit në xhaketë janë gjetur mjete monetare në vlerë prej 52,000.00 CHF.
	9 tetor 2021 Gjithsejt stoli argjendi 11.2 kg (unaza, vath, qafore, hallka dore, zingjire dore dhe qafe etj). Të gjitha mallrat janë konfiskuar ndaj udhëtares ka filluar procedura e rregullit kundërvajtëse.
	6 nëntor 2021 – ne pikë kalimin kufitar oficerët doganor kanë parandaluar futjen e mjeteve të punës të ndryshme gjatë tentim kontrabandës. Gjatë kontrollës në vendin e gomës rezervë është hasur në mall të padeklaruar i cili ishte fshehur me qëllim të kontrabandimit. Mallrat e gjetura ishim: vida të llojeve dhe madhësive të ndryshme, teha, rrafshuese me bateri. Të gjitha mallrat e gjetura janë konfiskuar si dhe është inicuar procedura kundërvajtëse.



23 nëntor 2021 – pas sigurimit të informatave përmes rrugëve operative Dogana e Kosovës me përkrahjen e Policisë së Kosovës sot kanë ndërmarr një aksion për kontrollimin e dyqaneve që merren me tregtimin e telefonave mobil. Aksioni ka qene i shtrirë në gjashtë lokacione të dyshuara , njësit e doganës kanë arritur qe gjatë aksionit të zbulojnë sasi të konsiderueshme të telefonave si dhe kanë gjetur hapësira të modifikura posaçërisht për fshehjen e telefonave brenda lokaleve të kontrolluara.



3 dhjetor 2021 në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës oficerët doganor gjatë kontrollit të udhëtarve kanë zbuluar mallra të fshehura në bagazh. Pasi imazhet e skanerit kanë dhënë indikacione që në valixhen e udhëtarit gjenden mallra të fshehura, oficerët pas hapjes së bagazhit kanë gjetur stoli të fshehura gjatë tentim kontrabandës. Andaj ndaj personit është inicuar kundervatje doganore si dhe mallrat janë konfiskuar ne sasi mbi 3 kg

	14 dhjetor 2021 oficerët doganor kanë parandaluar futjen e 100 fishekëve përmes aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës
	27 dhjetor 2021 Gjatë kontrolleve të ushtruara oficeret doganor ne pikë kalimin kufitar të Jarinjës në vijën e dytë të kontrollit në një automjet me targa të Serbisë kanë hasur në sasi të madhe të mallrave autopjesë të reja për vetura. Vlera fillestare e tyre është mendohet mbi 10,000 euro.
	27 dhjetor 2021 Oficerët doganor në pikë kalimin kufitar të Merdares kanë ushtruar kontroll në një autobus ku edhe kanë arritur të parandalojnë një sasi të konsiderueshme të mallrave të cilat barteshin nga një prej udhëtarve. Sasia e mallrave tregon qartë synimin për rishtije duke tentuar të shmangë taksat doganore.